



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së dytë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), mbajtur më 11.05.2023.

Lulëzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave të Komunës së Prishtinës, e hapi mbledhjen e dytë të KKSBB-së dhe i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues komunalë, përfaqësues të këshillave të bashkësive, përfaqësues të komuniteteve, përfaqësues të bashkësive fetare, përfaqësues të Policisë së Kosovës etj.

Kryesuesi pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë pikë në rëndin e ditës.

Njëzëri u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;
2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës;
3. Informatë mbi punën e Këshillave Lokalë të Sigurisë Publike në Prishtinës (KLSP);
4. Situata me zjarre pranverore, fushore dhe malore;
5. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra;
6. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë.

Hetem Kupina propozoi që në të ardhmen procesverbalit t'i bashkëngjiten përgjigjet në kërkesat e bëra nga anëtarët e këtij këshilli.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të KKSBB-së.

Pika e dytë

Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës.

Kapiten Bashkim Bytyqi, zv. komandant i Stacioni policor "Jugu", theksoi se gjendja e përgjithshme është e qetë dhe e qëndrueshme. Kemi një pasqyrim të përgjithshëm, ku është raportuar për periudhën 1 janar - 31 maj. Janë 1536 raste të ndryshme penale, janë shqiptuar 4434 gjopa për kundërvajtje të ndryshme në komunikacion, kemi pasur 15 raste të sulmeve nga qentë endacakë, si dhe 91 raste kundërvajtje për prishje të rendit dhe qetësisë publike.

Kapitene Melihate Sefedini, Stacioni policor "Veriu" në Prishtinë, tha se në përgjithësi mund të konstatoj se kemi gjendje stabile. Sa i përket rasteve të cilat janë raportuar në stacionin tonë krahasuar me periudhën e vitit të kaluar, kemi ulje të numrit të veprave penale 10.4% të rasteve të përgjithshme, kemi ulje në raste të veprave penale kundër jetës dhe trupit 18.6%, kundër pasurisë 11.7%, ulje në rastet e dhunës në familje 19.11%. Kemi ngritje të rasteve për armëmbajtje pa leje 18.36%, të aksidenteve 29.45% ngritje, gjopa të shqiptuara, kemi ngritje 18.97%.

Ajo në vazhdim tha se i kemi dy kërkesa, vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale në rrugën "Toni Bler", ku është tani Stacioni i policisë "Veriu", aty shenjat nuk janë të përshtatshme për atë lokacion. Njëherësh kemi një kërkesë nga prindërit dhe drejtorja e shkollës "Nazim Gafurri" që të vendosen pengesa në rr. "Bajram Bahtiri".

Toger Zekeria Januzi, shëf i sek. të operativës, Stacioni policor "Qendra" në Prishtinë, theksoi se në zonën e përgjegjesisë së stacionit "Qendra" situata e sigurisë është e qetë dhe e qëndrueshme, përkundër rasteve të kohëpaskohshme, por nuk ka pasur incidente të rënda. Sa i përket angazhimeve operacionale dhe hetimore në zbulim të veprave penale, kemi ngritur kapacitetet hetuese të zyrtarëve policorë në rroba civile. Sa i përket gjendjes së sigurisë në trafik, edhe këtu kemi angazhime shtesë. Në zonën e përgjegjesisë "Qendra" nuk kemi pasur aksidente me pasoja fatale. Drejtorja Rajonale e Policisë në Prishtinë ka krijuar një task-forcë shtesë që do të merret me çështjet e trafikut, në mënyrë që të krijohet siguri më e lartë. Sa i përket situatës dhe bashkëpunimit me shkolla, nga incidentet e fundit në rajon me pasoja tragjike, në vazhdimësi Stacioni "Qendër" ka në zbatim planin operativ "Siguria në shkolla". Jemi në kontakt në baza ditore edhe pas orarit të punës me menaxherë të shkollave, ku fatmirësisht nuk kemi pasur asnjë incident serioz. Konsiderojmë që në shkollat që mbikëqyrën nga Stacioni "Qendra" përfshirë edhe një shkollë private në lagjen "Bregu i Diellit", situata e sigurisë është e qetë.

Lulëzim Fushtica falënderoi parafolësit për raportimin me informata të sakta. Ai tha se brengë e qytetarëve për incidentet që kanë ndodhur në rajon sa i përket sigurisë në shkolla e kemi ngritur edhe me Drejtorinë e Arsimit. Së shpejti Drejtorja e Sigurisë dhe Emergjencave do të kontaktojë me policinë e Kosovës dhe do t'i vizitojmë shkollat e kryeqytetit. E kemi pasur një rast ku janë lënduar dy fëmijë në shkollën "Faik Konica". Ne si drejtori kemi marrë masa, kemi bërë inspektimin dhe kemi hartuar raportin për shkollën mbi të gjeturat. Në këtë drejtim, jemi duke punuar ngushtë me shkollën në fjalë dhe Drejtorinë e Arsimit, që të parandalojmë çdo incident të mundshëm.

Artur Krasniqi, Kisha Protestante, shtroi pyetje për zotëri Januzajn, duke thënë se në rr. "Rrustem Statovci", ne si banorë të lagjes ka kohë që kemi bërë kërkesë në DSHPMSSH për vendosjen e pengesave në rrugë, për shkak të shpejtësisë së madhe nga qytetarë të pandërgjegjshëm. Kemi marrë përgjigje negative, për shkak se nuk e kanë e parë të domosdoshëm një veprim të tillë. Ne si qytetarë e shohim rrezikun të përhershëm, sepse ka pasur edhe aksidente të shpeshta.

Çka mund të bëhet për sigurinë në trafik në këtë rrugë, që vazhdon të bëhet çdo herë e më e rrezikshme?

Toger Zekeria Januzi tha se ne nuk kemi pasur kërkesë për konstatim apo analizë për pengesat në rrugë, por po e marr si obligim që të vizitohet ajo rrugë nga policia dhe do të shtohen pikat e kontrollit të automjeteve për të skanuar gjendjen reale dhe së bashku me ju do t'i shqyrtojmë brengat për atë rrugë.

Habib Qorri bëri të ditur se në aspektin e sigurisë në trafik është duke u punuar pjesë-pjesë në qytet, për të gjitha kërkesat e qytetarëve, kështu që te komplet Lagjja e Muhaxhirëve kanë filluar me punuar dhe janë duke shkuar edhe nga rruga "Rrustem Statovci". Të gjitha rrugët janë duke u punuar me plan të veçantë.

Premtime Preniqi, koordinatori, bëri pyetje për statistikën në kuadër të këtyre rasteve, të cilat kanë pasur zbritje. Desha një sqarim sa i përket dhunës në familje, se a ishte paraqitja vetëm për muajin paraprak, apo për këtë vit komplet, sepse sipas disa statistikave viti ka filluar me një numër shumë më të madh të rasteve të dhunës në familje.

Kapitene Melihate Sefedini u shpreh se statistikën të cilat i posedoj janë nga 1 janari 2023 deri në fund të prillit 2023. Krahasuar me vitin e kaluar, dhuna në familje në rajonin e Stacionit policor "Veriu" ka rënie.

Malë Gashi, ushtrues detyre i udhëheqësit të Brigadës së Zjarrfikësve, ngriti si çështje vendosjen e pengesave në rrugë, duke thënë se duhet menduar edhe në aspektin tjetër, pengesat që po vendosen në rrugë po ndikojnë edhe në mjetet tjera emergjente. Prandaj po e them që është ndoshta e logjikshme me shikuar në një aspekt tjetër për këtë çështje, që policia me ofruar rekomandime ku me u vendosur pengesat më të vogla në rrugë, që do të ndikojnë prapë negativisht në shpejtësi të mëdha, pengojnë në realizimin e detyrave emergjente, por shkaktojnë edhe dëme të mëdha teknike në automjete.

Ai pyeti se a ka ndonjë metodë tjetër që mund ta mbajë nivelin e sigurisë si duhet, apo vetëm me pengesa.

Lulëzim Fushtica theksoi se në kuadër të kryeqytetit është krijuar task-forca për komunikacionin, e cila udhëhiqet nga nënkryetari Zogaj, ku edhe unë marr pjese bashkërisht me të gjitha institucionet përgjegjëse, to t'i trajtojmë të gjitha këto raste, duke i marrë parasysh të gjitha problemet që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë në komunikacion.

Pika e tretë

Informatë mbi punën e Këshillave Lokalë të Sigurisë Publike në Prishtinës (KLSP)

Violeta Hasani, KLSP "Qendra" theksoi se kemi disa probleme që i kemi zgjidhur, siç është çështja e rënies së fasadave, rënia e dërrasave nga mbindërtimet në objektet banesore etj. Unë konsideroj se një objekt banesor është sa komplet një lagje me shtëpi, sepse në një objekt janë 53 banesa banimi në rr. "Hajdar Dushi" etj. KLSP "Qendra" që nga viti 2014, takimet i kemi të rregullta mujore ku informohemi për problemet e qytetarëve. Në takime vazhdimisht japim mesazhe pozitive, ku kemi arritur të mbajmë një kontroll brenda komunitetit.

Në takimin e fundit ka qenë drejtori i OSBE-së, i cili e ka respektuar takimin tonë dhe na ka ardhur një letër falënderuese për Stacionin policor, Komunën dhe KLSP-në "Qendra", nga Driton Kelmendi, i cili e ka përcjellë mesazhin e drejtorit të Departamentit për Siguri Publike të OSBE-së.

Si KLSP "Qendra", i kemi realizuar mbi 7 projekte me OSBE-në, të cilat i ka financuar Ambasada norvegjeze, e kemi edhe një fushatë në zonën "Qendra" së bashku me OSBE-në.

Ne kemi planifikuar ta ndajmë një mirënjohje për koordinatorin Fatmir Bilalli, i cili ka reaguar shumë shpejt për çështjen e fasadave të banesave në zonën "Qendra", ku kanë shpëtuar nga rreziku shumë qytetarë.

Lulëzim Fushtica u shpreh se ne nuk mund të bëjmë asgjë pa shërbimin e zjarrfikësve të Komunës së Prishtinës dhe kjo mirënjohje shkon edhe për këtë shërbim dhe çdo pjesëtarë të policisë.

Hetem Kupina, KLSP Bardhosh me seli në Bërnice, tha se ky këshill funksionon në një mes më të madh, me popullatë shumetnike në komunën e Prishtinës, me qytetarë të komuniteteve jo shumicë. Nga viti 2004 e deri me tani, nuk kemi pasur asnjë konflikt ndëretnik, ndërnjerëzor, krejt kjo falë angazhimit dhe punës së shkëlqyer të policisë, të përfaqësuesve të komuniteteve, lagjeve, drejtorëve të shkollave etj. I mbajmë 12 takime të rregullta, së paku tri takime me drejtorë të shkollave, tri me përfaqësues të komuniteteve fetare dhe të komuniteteve të tjera.

Temat të cilat ne i trajtojmë janë: siguria në shtëpi, siguria në rrugë, siguria në shkolla dhe siguria në institucione, japim ide si me i zgjidhur problemet. Kemi kërkuar që në shkolla të kemi psikologë, ku përmes tyre e kuptojmë se a ka dhunë në familje.

Kemi kontakte me KFOR-in, OSBE-në, marrim këshilla dhe sugjerime, me punë ndershmëri dhe përkushtim maksimal që të respektohen të drejtat e çdo komuniteti, për këtë jemi në mesin e më të mirëve.

Safiye Beseni, KLSP "Dodona", tha se në kuadër të KLSP-së sonë funksionojnë 5 shkolla, takimet individuale nuk kanë munguar. Drejtorët e shkollës dhe përfaqësuesit e lagjes problemet i paraqesin në rrjetet sociale dhe në grupet e krijuara. Njëri nga problemet që është duke u shfaqur dhe është shumë shqetësuese, është një person me të meta psikike, është i mitur, i cili i ngacmon fëmijët në shkollën "Elena Gjika" dhe "Gjergj Fishta". Ka raste kur policia është marrë me të, por pasi që është i mitur procedurat ishin më të koklavitura, andaj dëshirojmë që sa më shpejt të bëhet një zgjidhje për këtë, në mënyrë që të mos vijmë deri te një eksces më i rëndë.

Vazhdimisht kemi ankesa për kamera, se janë disa rrugë aty ku ndriçimi nuk funksionon dhe rreziku është më i madh. Është diskutuar për një projekt që është duke u bërë, por nuk e dimë në çfarë faze është.

Vebi Mujku, drejtor i QPS-së, theksoi se kemi probleme shumë të mëdha me persona me aftësi të kufizuara dhe probleme mendore, të cilët janë agresiv. Ne si Komune e Prishtinës nuk e kemi asnjë shtëpi me bazë dhe komunitet për t'i vendosur këta persona, mirëpo e kemi vetëm një institucion në Shtime dhe për fat te keq atje është numri i stërmbushur. Me kryetarin Rama dhe drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, e kemi biseduar këtë çështje, që në vitin e ardhshëm ta ngremë një shtëpi me bazë në komunitet vetëm për komunën e Prishtinës. Ata qytetarë të cilët ne i kemi të pozicionuar janë në 8 shtëpi me bazë në komunitet anë e mbanë Kosovës e nuk është asnjë në Prishtinë, sepse niveli qendror nuk ka transmetuar asnjë institucion të tillë.

Këto raste nuk janë vetëm çështje e policisë, por neve na mungon kjo si komunë dhe shpresoj që vitin e ardhshëm do ta gjejmë lokacionin.

Zekerija Jonuzi tha se sa i përket çështjes në fjalë, e ndajmë shqetësimin me ju zotëri Mujku, jemi të kujdesshëm, jemi në fokus të medieve të ndryshme dhe jemi të detyruar të veprojmë me kujdes ndaj kësaj dukurie shumë të ndjeshme.

Lulëzim Fushtica, sa i përket çështjes se kamerave, tha se ne jemi në fazën përfundimtare, mjetet janë, buxheti është i ndarë, por duhet të keni parasysh se kjo shkon me faza gjatë tri viteve dhe faza e pare është për pikat kryesore të udhëkryqeve në hyrje të kryeqytetit, pastaj vazhdojnë në pikat tjera të cilat përcaktohen nga policia e Kosovës.

Ilmi Uka, KLSP Keqekeollë, bëri të ditur se në këtë KLSP përfshihen 8 fshatra, dhe vlen të theksohet se është ndoshta nga vendbanimet më të qeta. Puna jonë konsiston me punët që kryhen edhe në KLSP-të tjera, por i ka karakteristika e veçanta, sepse është një zone rurale dhe problemet e tyre janë specifike. Bashkëpunimi polici - shkolla është jashtëzakonisht i mirë. Banorët janë shpërngulur shumë, ka mbetur një numër i vogël i banorëve, problemi qëndron te pushteti, sepse menjëherë pas luftës së fundit nuk është intervenuar atje me infrastrukturë, andaj qytetarët e kësaj zone janë orientuar nga qyteti. Rrezikojmë të mos mbetet asnjë. Në një mbledhje të mbajtur në Komunë kam kërkuar që të investohet në zonën rurale, sepse nuk do të mbetet askush në atë zonë. Kemi problemin e mbylljes së shkollave, që tash po planifikohet se ku t'i vendosim nxënësit e fshatrave të ndryshme në atë pjesë. Pra, nuk kemi të bëjmë me probleme të vendeve urbane, por me ato rurale. Ne punojmë atë çka mundemi, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin, që të arrijmë që gjendjen ta mbajmë të qetë.

Lulëzim Fushtica tha se Komuna e Prishtinës ka filluar me projekte për përmasimin e infrastrukturës në pjesën e Gollakut, për një zhvillim të aspektit turistik e të tjera.

Gentiana Osmani, KLSP "Mati 1", Lagjja e Spitalit, bëri të ditur se ka një vit e pak që është themeluar si KLSP. Jemi angazhuar vazhdimisht, takimet fizike janë ende një sfidë për ne si KLSP e re, mirëpo një gjë që më ka ndihmuar shumë është përdorimi i rrjeteve sociale. Lagjja "Mati 1" dhe Lagjja e Spitalit konsiderohen si lagjet më të mëdha në shtetin e Kosovës, me mbi 30.000 banorë. Derisa ne po e mbajmë këtë mbledhje, është duke u mbajtur një protestë në rrugën "Jakov Xoxa", kërkesa është bërë për shkak se po konsiderohet që po bëhen punimet paralele në rrugën "B", tek banesat "Injenering" tek trembëdhjetëkateshet. Policia janë në dijeni, pasi që fatmirësisht brenda grupit janë pjesëtarë edhe policia e Kosovës, është njoftuar edhe KFOR-i për këtë protestë. Kërkesa e banoreve është që me u marrë parasysh këto punime, pasi që qasja e vetme në këtë rast do të mbetet ose rr. "Muharrem Fejza", ose rr. "C", ku kjo paraqet një shqetësim të madh për banorët që jetojnë tek rr. "Jakov Xoxa".

Një problematikë tjetër është rr. "Uran Ajeti", ku tek kompleksi "Nderimi" është një vendpunishte që konsiderohet rrezik për jetën e banoreve, sepse nuk ka izolime të duhura të parapara për këtë qëllim. U potencua për rastet e fundit që kanë ndodhur në rajon. Në mbledhjen e fundit, drejtori i shkollës "Pavarësia", Shefki Rusinovci, shprehu shqetësimin dhe është i hapur për çdo iniciativë që organizohen trajnime, fokus grupe shtesë për nxënësit e shkollës.

Kërkesë tjetër për një nënstacion policor në zonën tonë, duke e marrë parasysh numrin e madh të banorëve.

Naim Bajraktari, KLSP "Ulpiana" – "Bregu Diellit", u shpreh se mbledhjet i mbajmë rregullisht, kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Stacionin policor "Jugu". Pasi jemi KLSP e re, nuk kemi shumë kërkesa, sepse ende nuk janë informuar qytetarët, po përpiqemi ta shtojmë numrin e anëtarëve. Ka dy muaj që e kemi paraqitur një projekt, e kemi dorëzuar, për objektin e kompanisë "Lesna", meqenëse lagjet "Ulpiana" dhe "Bregu i Diellit" janë 95% banim kolektiv. Ne kemi kërkesa më shumë të emancipimit me një bashkëjetesë kolektive.

Këto ishin problemet më të mëdha në terren, por tek "Lesna", janë shumë të shqetësuar banorët, sepse aty zhvillohen disa veprimtari të jashtëligjshme, kati i dytë është i pambrojtur. Çka ishte më e keqja, me policët e lagjes e kemi vizituar dy herë atë zonë, dy fëmijë të ndalur, kur i kontrolluam ju gjeten armë të ftohta, gjetëm mbeturina të narkotikeve. Ishte një zonë me shumë parregullsi, njëra që i takon policisë, tjetra Komunës për mirëmbajtje te objektit. Ka dy muaj që kemi kërkuar vendosjen e kamerave, tjetra kontrolli nga policia, kërkesë tjetër e veçantë, tek pompa e benzinës, kane kërkuar disa herë që ajo rrugë të mos mbyllet, por të paktën të behet njëkahore, sepse është rrugë e ngushtë për dy krosi.

Lulëzim Fushtica tha se sa i përket objektit të "Lesna"-s, e kemi pranuar kërkesën, e kemi vizituar bashkërisht me ish-komandanten Vjollca Hoti, e cila ka shprehur shqetësim të jashtëzakonshëm, e kemi hartuar raportin, dhe në bazë të mundësive që ka Komuna do të reagojë. Sa i përket rrugës njëdrejtimshe, drejtojeni tek unë, do e parashtrij si pikë diskutimi në takimin e radhës së task-forcës.

Pika e katërt

Situata me zjarre pranverore, fushore dhe malore.

Brigada e Zjarrfikësve në vitin 2021, ka përfshirë të gjitha zjarret malore dhe fushore, ka qenë numri më i lartë krahasuar me vitin 2022, ku kemi pasur gjithsej 1106 intervenime. Në krahasim me vitin 2022 shihet një rënie me 889 intervenime me pak, gjithsej kanë qenë 717 intervenime në zjarre të ndryshme. Sa i përket vitit 2023, ka filluar mirë edhe për shkak të kushteve atmosferike. Si rekomandim, ndoshta është mirë të bashkëveprojmë me Drejtorinë e Inspeksionit. Shihet një fenomen tek deponitë ilegale nga qytetarët e pandërgjegjshëm, e për këtë besoj se drejtoria duhet të jetë më aktive ndaj këtyre fenomeneve. Sa i përket kontejnerëve të rijnë të plastikës, qytetarët e pandërgjegjshëm shkaktojnë i ndezin mbeturinat bashkë me kontejnerë.

Malë Gashi tha se vitin e kaluar e kemi pasur një takim me këshillat për mos ndezjen e zjarreve fushore. Në muajt korrik, gusht dhe shtator rritet numri i intervenime për shuarjen e zjarreve. Gjendjen e kemi pak më keq se vitin e kaluar sa i përket personelit dhe automjeteve, por besoj se do të arrijmë t'i zgjidhim, mirëpo ne me kapacitetet që kemi do të jemi në gatishmëri për të reaguar, në të gjitha aspektet. Sa i përket zjarreve fushore, kemi një diferencë të jashtëzakonshme me intervenimin në atë sezon krahasim me vitin 2021 me 2022. Në këtë drejti, kisha rekomanduar që këshillat të bashkëpunojnë me ne, me qytetarët, sidomos me bujqit. Ligjërisht a mund të kushtëzohet kur bëhen korrje-shirjet e grurit zakonisht bujqit i ndezin mbetjet, me pretendim se do të pastrohet ajo tokë. Bujqit të cilët e bëjnë korrjen e grurit, kish qenë mirë me bërë një ndarje fizike, me livruar, nëse nuk mundet të gjithë sipërfaqen, atëherë me bërë një perimetër të sigurisë me lëvrim, sepse ndezja e zjarrit është vepër penale.

Po ashtu, jemi të hapur me bërë ushtrime bashkërisht edhe me shkollat, mësimdhënësit dhe nxënësit.

Zekeria Januzi bëri të ditur se nga dt. 3 maj, policia e Kosovës në nivel vendi ka zbatimin e projektit për parandalim të dukurive të zjarrit, që është i ndarë me faza të caktuara, veç kemi me ndërmarr veprime me qytetarë, KLSP-të etj., që kjo çështje me u përhapur. Vetëdijesimi në nivel i sigurisë në shkolla duhet kërkuar nga AMJ-ja në projekt me DKA-në, që me u bërë një projekt sensibilizues në nivel të ligjërimit ditor nëpër shkolla të veçanta, me moshën e të rriturve që kalon klasën e pestë.

Ilmi Uka tha se bashkëpunimi ynë me zjarrfikësit është i natyrshëm, duhet pasur parasysh një gjendje të përgjithshme, që kur kërkohet bashkëpunimi duhet pasur edhe një përgatitje paraprake, që me marrë pjesë në shuarjen e zjarrit, por mjetet elementare nuk janë! Ne mundemi vetëm me i lajmëruar me kohë për fillimin e një zjarri, por kishte qenë mirë me pasur stimulim me mjete pune, me aktivitete, këshilla nëpër bashkësitë lokale etj.

Lulëzim Fushtica u shpreh se, sipas planit tonë për këtë, kemi biseduar edhe me Brigadën e Zjarrfikësve, do t'i krijojmë njësitë vullnetare të zjarrfikësve në kryeqytet.

Malë Gashi bëri të ditur se çdo institucion është i obliguar të ndërtojë planin e reagimit të emergjencave. Për ne është tepër i rëndësishëm edhe komunikimi me këshillat komunalë, për faktin se neve na orientojnë se cilat janë veprimet që duhet me u ndërmarrë.

Kurdo, cilido kryetar që dëshiron me organizuar për komunitetin që e mbulon, me iu ofruar njohuri se si duhet të reagohet në ndaj zjarreve të ndryshme, jemi të gatshëm për këtë.

Violeta Hasani u ndërlidh me diskutimin e zotëri Ukajt, duke thënë se, sa për njoftim, prej KLSP "Qendra", OSBE i ka trajnuar në rastin për zjarrfikës 3 anëtarë, certifikimi ka qene 5-ditor, janë trajnuar në aspektin teorik dhe praktik.

Pika e pestë

Trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra.

Lulëzim Fushtica, lidhur me këtë çështje, tha se unë i kam lexuar dhe i kam marrë të gjitha raportet që kolegët tanë të sektorit të emergjencave, i kanë përgatitur çdo herë në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe me KLSP-të. Për periudhën e vitit 2022, i kam raportet e objekteve të pashfrytëzuara, të vjetra dhe të braktisura, që është një problem i ngrite për dy sfera. E para, është që kemi shumë objekte që janë ndërtuar nga institucione të ndryshme, objekti "Interx", që është tek rrethi i Spitalit, është partneritet publiko privat, ku kemi pasur ankesa, kemi mbajtur takime për këtë çështje. Ka shume objekte në kryeqytet, por edhe në fshatrat përreth, që janë të pashfrytëzuara dhe të braktisura. Ne si Komunë nuk kemi të drejtë t'i rrënojmë objektet private, kemi objekte që janë në mbrojtjen e Ministrisë së Kulturës etj., ne kërkojmë nga ju që fillimisht të diskutojmë dhe të bëjmë një zgjidhje të përbashkët, të gjejmë një mënyrë se si t'i trajtojmë.

Fatmir Bilalli bëri të ditur se kjo është kërkesë e kamotshme, është problematikë shume e madhe, por që kërkon zgjidhje. Inspeksioni mund të japë kontribut shumë të madh në këtë aspekt. Problemi më i madh i tyre është përdorimi i këtyre shtëpive të braktisura nga narkomanët, mbeturina dhe dukuri të tjera negative. Në vitin 2023, pas themelimit si drejtori, kemi filluar identifikimin e të gjitha objekteve dhe regjistrimin e tyre në të gjithë territorin. Bashkëpunimi me KLSP-të, është një ndihmë shumë e madhe për ne. Presim që të dhënat e tyre do të na ndihmojnë shumë, por Drejtoria e Inspeksionit është ndihma kryesore në këtë aspekt.

Lulëzim Fushtica tha se në këtë fazë për identifikimin dhe përgatitjen e raportit të përgjithshëm, kërkojmë nga KLSP-të që të na ndihmojnë në identifikim, mirëpo ndoshta edhe me informata më të detajuara. E kemi një pikë për dinamikën e planit të punës për këtë vit, i kemi krijuar ekipet, kemi marrë staf të ri në drejtori, që janë të certifikuar për këtë çështje, kështu që në javët në vazhdim kolegët do të kontaktojnë me kryesuesit dhe bashkërisht do të bëjmë identifikimin dhe përgatitjen e këtij raporti.

Fatmir Bilalli theksoi se jemi duke e bërë edhe regjistrimin e objekteve kolektive, bodrumeve, të cilat janë të pafunksionalizuara dhe në bashkëpunim me qytetarët, për të ndërmarrë masa për pastrimin e tyre.

Lulëzim Fushtica tha se ne e kemi identifikuar edhe në objektin e "Lesna"-s, një strehimore publike, e cila gjendet në bodrum, kemi bërë inspektimin e kësaj strehimoreje, është strehimorja e pestë në kryeqytet, e cila është ndërtuar në vitet e 70-ta, 80-ta, dhe e kemi bërë raportin sa i përket gjendjes së strehimoreve në kryeqytet, ku një prej tyre gjendet në objektin e "Lesna"-s, afër Stacionit të autobusëve, hyrja e parë nga mbrapa, e cila është në gjendje shumë të keqe. Për këtë ne do të bëjmë planin për rivitalizimin e asaj hapësire. Ne këtë rast kërkojmë ndihmën dhe bashkëpunimin e KLSP-ve, që t'u ndihmojnë kolegëve tanë në inspektimin e këtyre hapësirave.

Pika e gjashtë

Të ndryshme.

Përfaqësuesja e komunitetit boshnjak, tha se sa i përket situatës së sigurisë, të gjitha komunitetet janë të kënaqura, me përjashtim të dy rasteve të komunitetit serb. Në muajin mars në Bërnice nga komuniteti serb është bërë një raportim, ku kanë ndodhur dy vjedhje në dy shtëpi, në njërin janë marrë 20.000 euro para, në tjetrën disa gjëra materiale. Në mbledhjen e katërt të Komitetit për Komunitete, të mbajtur më 25 prill, gjendja e sigurisë në komunitete ka qenë e mirë, përveç të komuniteti rom, ku përfaqësuesi i komunitetit na ka lajmëruar se në lagjen e tyre ku ai jeton ka ndodhur edhe një vjedhje, e cila është paraqitur në polici, por pas tri ditëve ka ndodhur edhe njëherë, edhe në ditën e katërt përfaqësuesit e komunitetit rom ia kanë thyer dyert e shtëpisë.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur një mbledhje në muajin prill, në Zyrën për komunitete në nivel qendror, kemi marrë informatat interesante që do t'i ceku këtu. Për të identifikuar keqpërdorimin e të miturve lëmshëkërkues nga komunitetet jo shumicë, dy fëmijë janë të braktisur, janë nga Fushë-Kosova, dhe nga 20 - 24 mars, në gjyç janë pranuar 26 lëndë, të cilat i përkasin trafikimit me qenie njerëzore. Të njoftuar janë Policia dhe Ministria e Punëve të Brendshme, po ashtu 25 të komunitetit rom kanë aplikuar për punë në polici dhe 12 prej tyre kanë kaluar testin.

Lulëzim Fushtica ua dha fjalën përfaqësuesve të bashkësive fetare për çështjet që dëshirojnë t'i diskutojnë.

Agim Çerkini, prift katolik, theksoi se përveç koncerteve treditore që u mbajtën pranë katedrales, është vërejtur një dukuri, adoleshentët shërbeheshin me alkool dhe duhan, është vërejtur moskujdesi për mirëmbajtjen e ambientit, që është përgjegjësi e të gjithëve. Dua t'i përgëzojë përfaqësuesit e bashkësive në nivel lokal, sepse janë treguar shumë korrekt në bashkëpunim me qytetarë, pa i lënë anash edhe zjarrfikësit, që janë heronj për punën që e bëjnë. **z. Shehu**, përfaqësues i tarikateve, u shpreh se në nivel komunal nuk kemi shumë shqetësime, ndërsa në nivelin e lartë kemi disa shqetësime.

Artur Krasniqi, Kisha Protestante Ungjillore, theksoi se ne i kemi 4 kisha protestante në qytetin e Prishtinës. Si Kishë Protestante, ne përpiqemi të kemi bashkëpunim të mirë me Komunën e Prishtinës. Së fundmi, bashkë me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale kemi bashkëpunuar në koordinimin e çështjes së ndihmave humanitare, ku shumica prej bashkësive fetare janë të përfshira në dhënien e ndihmave. Ne e kemi parë si shqetësim që disa njerëz po përfitojnë tepër shumë, dhe kemi kërkuar nga Komuna me bërë koordinim më të mirë sa i përket kësaj çështje, sepse ka njerëz që përfitojnë shumë e disa të tjerë janë në nevojë. Si bashkësi fetare, mendoj se e kemi përgjegjësinë dhe detyrën me iu ndihmuar në çështje sociale për të gjithë ata që i takojnë komunës së Prishtinës.

Ne para disa muajsh kemi hapur një Qendër rehabilitimi të narkotikëve në një fshat të Prishtinës, që t'i ndihmojë njerëzit me u liruar prej varësisë. Për ne Drejtoria e Inspeksionit mbetet sfida më e madhe.

Kohët e fundit jemi ballafaquar, në pjesën e Lagjes së Muhaxhirëve, me investimet që ka bërë ndërmarrja "Termokos", kishte qenë mirë me dalë me inspektuar se në çfarë gjendje e kane lënë rrugën.

Përfaqësuesi i komunitetit serb, Bernica e Poshtme, tha se gjendja e përgjithshme e sigurisë është e kënaqshme, por nuk do të thotë se nuk kemi probleme. E kemi kuptuar se dikush po i sjell qentë endacakë në territorin tonë. Kemi pasur një sulm në fëmijë prej qenve endacakë,

dikush ...

Lulëzim Fushtica theksoi se jemi të gatshëm, kemi biseduar edhe me zotëri Kupinën, qe të kemi një takim të ndarë me komunitetin serb në atë lokalitet, që të dëgjojmë çështjet dhe problemet që i kanë ata.

Hetem Kupina u shpreh se disa herë e kam përsëritur, që në të ardhëm të bazohemi në përmbajtjen e pikës së rendit të ditës. Në njërën nga mbledhjet e kaluara, kam kërkuar nga procesmbajtësit që në pikën "Të ndryshme", të shkruajnë po ashtu edhe adresimin për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë.

Po e përcjell mesazhin e komunitet serb. Është duke u ndërtuar një rrugë tek stadiumi në Bardhosh, më dt. 27 e kanë një ceremoninë fetare, por nuk kanë qasje për të hyrë në kishë, sepse ata që e kanë ndërtuar rrugën kanë vendos material në rrugë. Ata kërkojnë që brenda mundësive të largohet ai material dhe t'u mundësohet qasja në kishë.

Kam qenë kryetar i komisionit për çështje pronësore-juridike, ku në atë kohë kam kërkuar të formohet komisioni për identifikimin e pronave të uzurpuara komunale, është shqetësim i qytetarëve, brengë dhe bela. Është formuar komisioni, i ka identifikuar 742 uzurpime në komunën e Prishtinës, nuk kanë ndërhyrë sepse është një rrezik i lartë.

Procesmbajtësja
Edona Krasniqi

Kryetari i Komunës
Përparim Rama

